



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 13-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më
30. 01. 2015 në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese
2. Labinot Shahini, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Daut Azemi, anëtar
5. Agron Hajdini, anëtar
6. Arton Retkoceri, anëtar
7. Naim Jahiri, anëtar
8. Burbuqe Fazliu, anëtar
9. Linda Shahini, anëtar
10. Xhevat Olluri, anëtar
11. Rizah Bajraktari, anëtar
12. Ukë Kryeziu, anëtar
13. Merita Zeqiri-Hajrizi, anëtar
14. Hajrije Salihu, anëtar
15. Blerim Gashi, anëtar
16. Albulena Gashi, anëtar
17. Florent Hoxha, anëtar
18. Petrit Kelmendi, anëtar
19. Ragip Zejnullahu, anëtar
20. Nazmi Krasniqi, anëtar
21. Enver Kozhani, anëtar
22. Feriz Hasani, anëtar
23. Ali Stublla, anëtar
24. Valbona Shillova, anëtar
25. Burbuqe Ilazi, anëtar
26. Vlora Buja, anëtar
27. Arben Bahtiri, anëtar
28. Edita Gashi, anëtar
29. Ramiz Qeriqi, anëtar
30. Zoran Çirkovic, anëtar
31. Xhavid Maholli, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Fitim Selimi, Nënkyetar i Komunës
2. Sefer Tasholli, Nënkyetar i Komunës
3. Shkelzen Hajdini, Drejtor DBF
4. Rasim Hasani, Drejtor i arsimit
5. Remzi Mehmeti, DMSH
6. Latif Ramadani, Drejtor i DEZH
7. Basri Hashani, Drejtor i DKRS
8. Avdullah Fazliu, Drejtor i Shëndetësisë
9. Heset Sahiti, Drejtor i Sherbimeve Publike
10. Imer Rrustemi, Drejtor i Inspektionit
11. Ilir Tasholli, Drejtor i Urbanizmit
12. Fauz Xhemajli, Drejtor i Administratës
13. Avni Olluri, Drejtor i Kadastrit
14. Vlora Krasniqi, zyra ligjore
15. Kimete Jashanica, përfaqësuese e OSBE-së
16. Bekim Krasniqi, "YAHR"
17. Venera, OSBE
18. Përfaqësuesi i OJQ "Ballkan"
19. Alban Nuredini, Zëdhënës i Komunës
20. Përfaqësuesit e mediave
21. Naser Bytyqi- përkthyes, shqip-serbisht
22. Rifat Hoxha- përkthyes, shqip-serbisht

Proqesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Sami Murati**.

Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni, pas konstatimit se në mbledhje prezantojnë 30 anëtarë të Kuvendit dhe se ekziston kuorumi për punë dhe vendosje të plotëfuqishme hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se rendin e ditës e keni marrë a ka dikush vërejtje apo plotësime?

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë përkatësisht nuk pati vërejtje, as plotësime Kryesuesja vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me shumicën absolute 31 vota për punën e kësaj mbledhje miratoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 12-të e KK-së
2. Propozimi i Vendimit për rritjen e Buxhetit të Komunës së Lipjanit nga tejkalimi i të hyrave vetanake për vitin 2014.
3. Propozimi i Vendimit mbi dhënien e pëlqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitit 2013 dhe 2014 në vitin 2015.
4. Shqyrtimi i propozim Vendimit për plotësimin e Vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të palujtëshme të Komunës 15Nr.464-40375/2014
5. Shqyrtimi i propozim Vendimit për plotësimin e Vendimit për dhënien në shfrytëzim të tokës pasuri shoqërore e KK Lipjan ,KBI (Këshillit të Bashkësisë Islame) për Xhaminë e Fshatit Gadime e Epërme 15Nr.464-40387/2014 dhe
6. Shqyrtimi i propozim Vendimit për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare BI në Lipjan .

Para se të kalohet në punë sipas rendit të ditës së aprovuar, Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni pyeti anëtarët e Kuvendit se a ka dikush të shtoj diqka.

Florent Hoxha, ne grupi parlamentar i PDK-së më herët kemi ngritë disa shqetësime dhe nuk kemi marr përgjigje, andaj është mirë që të na ktheni përgjigjet me shkrim për shqetësimet që kemi parashtrur siqë është për pronën te tregu i kafësve se kujt i është dhënë kjo pronë.

Zoran Çirkoviq, unë kam kërku që të rregullohet ndriqimi prej Shtëpisë së Kulturës deri te Kisha dhe kjo nuk është bërë, andaj kërkoj përgjigje nga Drejtorati për Shërbime Publike.

Nazmi Krasniqi, punëtorët e arsimit janë në grevë dhe unë shprehi shqetësimin pse askush gjerë me tani as ekzekutivi as legjislativi nuk kanë paraqitë asnjë informatë apo raport për gjendjen në arsim e gjithashtu as për suksesin e nxënësve për gjysëmvetorin e parë.

Ramiz Qeriqi, në vitin e kaluar kam pas disa kërkesa që nuk janë realizu dhe ato janë:

- Që në Sheshin “Adem Jashari” të ngritet një monoment që simbolizon Dëshmorët dhe Martirët e Luftës.

- Që Veteranët e luftës dhe skamnorëve tu ipen në shfrytëzim disa banesa që janë në pronësi të komunës.

- Kam kërku që të mirëmbahen monamente historike.

- Kam kërku që të caktohet një lokal muze historik.

Dhe të gjitha këto nuk janë realizu e besoj se këtë vit do të realizohen.

Pastaj tha se falenderoj këtë qeveri dhe Kryetarin që me 14 dhjetor ka organizu një darkë për veteranët e luftës dhe në atë darkë kemi ndarë disa paketa si ndihmë për familjet e Dëshmorëve, veteranët e luftës dhe skamnorët.

Në fund tha se është edhe një ankesë në fshatin Ribar i Madh rreth emërtimit të rrugëve ku këtu është cenu edhe familja ime meqë aty është vra halla ime dhe gjatë emërtimit të rrugëve në këtë fshat nuk është marrë parasysh ky emër a rrugët janë emërtu me emëra që ndoshta kanë humbur jetën tragjikisht, andaj konsideroj se këtë qështje do ta përmirësoj kjo qeveri.

Heset Sahiti, rreth ndriqimit kemi pasur një procedur të prokurimit dhe ka dështu tenderi dhe përsëri do të del tenderi për ndriqim.

Rasim Hasani, sa i përket pyetjes së Nazit lidhur me raportin e suksesit të nxënësve në gjysëmvetorin e parë ju njoftoj se ky raport i është dorëzuar Kryetarit dhe së shpejti do ta keni për shqyrtim.

Sa i përket grevës ne as atëherë nuk jemi pyetur kur është nënshkru kontrata dhe na nuk jemi përzi në grevë dhe nuk kemi vizitu asnjë shkollë gjatë grevës. Greva për neve është e pa pranueshme dhe konsideroj se sindikata nuk ka të drejtë me i ftu nxënësit që të ndërprejnë mësimin dhe unë nuk pajtohem me këto veprime.

Pasi pyetje tjera nuk pati u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 12-të e KK-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja, Vlora Limani-Hajnuni pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 12-të të Kuvendit?

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë përkatësisht nuk pati vërejtje, as plotësime Kryesuesja vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 30 vota për

Aprovoi

Ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 12-të të Kuvendit pa vërejtje

Shtesë: Ekstrakti.

II

Propozimi i Vendimit për rritjen e Buxhetit të Komunës së Lipjanit nga tejkalimi i të hyrave vetanake për vitin 2014.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Shkelzen Hajdini, Drejtor i DBF-së i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim i Vendimit, duke shtuar që në nenin 1 të Vendimit ku thuhet në shumë prej 136,382.86€ është një gabim për 1€ dhe duhet të jetë 136,381,86€ andaj kërkoj që këtë Vendim ta aprovoni me këtë përmirësim.

Pastaj Kryesuesja Vlora Limani-Hajnuni hapi shqyrtimin?

Labinot Shahini, falënderoj Drejtorin që na njoftoi lidhur me rritjen e Buxhetit dhe tejkalimin e të hyrave vetanake dhe na si grup parlamentar i LDK-së e mbështesim këtë propozim Vendim dhe përshëndesim ekzekutimin për efikasitetin që ka pas në realizimin e të hyrave dhe tejkalimin e të hyrave vetanake.

Merit Zeqiri-Hajrizi, e përshëndes Drejtorin për paraqitjen e këtij Vendimi dhe e përkrahu këtë Vendim. Në vazhdim kërkoj që të kontrollohet kombi që bartë nxënësit meqë në kombi tejkalohej numri i lejuar dhe paraqet rrezik. Gjithashtu tha se kemi disa nxënës me sindrom të daunit në disa shkolla dhe është mirë që këta nxënës të bartëm për mësim në Lipjan me që kemi një paralele për nxënësit me aftësi të kufizuara.

Florent Hoxha, në vitin 2013 taveni i të hyrave vetanake ka qenë 1.700.000,00€ kurse në vitin 2014 është zvoglu ky tavan dhe është mirë që ka tejkalim por kërkoj që këto mjete të ndahen në mënyrë proporcionale për projektet që janë në vazhdimësi. Ne si grup parlamentar i PDK-së e përkrahim këtë propozim Vendim.

Blerim Gashi, na e përshëndesim këtë rritje të të hyrave vetanake dhe e përkrahim këtë propozim Vendim dhe uroj që projektet që kanë qenë në vitin 2014 të vazhdojnë për realizim në vitin 2015 në mënyrë që mos të mbesin pa u realizu 3-4 vite.

Petrit Kelmendi, është mirë që ka rritje të të hyrave vetanake dhe kemi dy lloje të të hyrave, të hyrat e njëhershme dhe të hyrat e përhershme ku Komuna mund të ketë një zhvillim më të mirë me tejkalimin e planifikimit të të hyrave vetanake. Unë edhe në KPF kam thënë për projektin për rrugën 4 korsi që njëherë është hjekë nga asambleja komunale dhe është fshi ky kod dhe nuk e di se ky projekt a do të kthehen edhe njëherë në Kuvend apo jo.

Nazmi Krasniqi, në bazë të këtyre rezultateve që janë arrit, pyes Drejtorin se sa është rritja e zhvillimit ekonomik në Komunën e Lipjanit kuptohet përqindja.

Agron Hajdini, planifikimi ka qenë 1.486.000,00€ a janë realizu 1.623.000,00€ a duhet ta keni parasysh se është hjekë taksa për leje të punës për biznese dhe sikur të mos ishte hjek kjo taksë atëherë do të kishim realizim më të madh.

Petrit Kelmendi, askush nuk e konteston rritjen e të hyrave vetanake por na nuk guxojmë me mendu se nga viti në vit kemi të hyrat e njëjta vetanake, andaj duhet të angazhohemi që të kemi rritje të të hyrave vetanake në mënyrë që të kemi një zhvillim më të madh ekonomik.

Shkelzen Hajdini, vitin e kaluar ka pasur ndërtim dhe nga ndërtimi realizimi i të hyrave ka qenë vetëm 17.000,00€. Taveni i të hyrave nuk ka lidhje po me rëndësi është sa janë realizu të hyra se në vitin 2013 taveni ka qenë 1.700.000,00€ kurse në vitin 2014 na kemi realizu 1.623.000,00€ qka do të thotë se është realizu 95% e tavanit prej 1.700.000,00€.

Sa i përket projektit për rrugën 4 korsi e kemi hjek dhe ka votuar asambleja se është lidh kontrata për këtë projekt pa mbulesë të mjeteve dhe rishikimin e buxhetit e bënë parlamenti i Kosovës dhe ju e dini se nuk është bërë ky rishikim meqë nuk ka pasur Kuvend.

Na me ridestinimin që e bënë Ministria e financave nuk na ka leju me e hjek këtë projekt me arsyetimin se për këtë projekt është lidh kontrata.

Sa i përket kombibusit që pyeti Merita na me vështërsi po i gjejmë mjetet me i paguar atë kombibus e mos të flasim për të siguruar tjetër kombibus.

Petrit Kelmendi, askush nuk është kundër për implementimin e projekteve por pyetja ime ishte se a do të shfuqizohet Vendimi i Kuvendit për hjekjen e projektit për rrugën 4 korsi.

Shkelzen Hajdini, na e kemi inicu qështjen e projektit për rrugën 4 korsi “Hajredin Bajrami” por ai vendim nuk është realizu meqë rishikimi i buxhetit nuk ka ndodh nga instancat më të larta të vendit andaj nuk ka qka mu shfuqizu kurfarë vendimi meqë nuk është aprovu.

Florent Hoxha, i përmendi Drejtori se ka tejkallim të të hyrave vetanake, por sikur tavani të kishte qenë 1.700.00€ ju nuk do të kishit tejkallim dhe nuk do të kishte ridestitim. Ju gjatë ridestinitimit të mjeteve keni parapa projekte të reja e që me ridestitim nuk keni pasë të drejtë.

Labinot Shahini, unë e pash që u politizu kjo qështje që nuk patë nevojë me u politizu se edhe Petriti edhe Florenti janë asambleistë dhe të dytë e dijnë se nuk ka pasur as rishikim as ridestitim të buxhetit. Në vazhdim tha se kush mund me e kontestu realizimin e të hyrave nga lejet e ndërtimit që në vitin 2013 ka qenë 17.000,00€ dhe tani në vitin 2014 është rritë në 191.000,00€.

Me që diskutime tjera nuk pati Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit me ndryshimin e nenit 1 të Vendimit për 1 euro të propozuar më lartë nga Drejtori për Buxhet dhe Financa dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 28 vota për 1 apstenim miratoi këtë:

**VENDIM
PËR RRITJEN E BUXHETIT TE KOMUNËS SË LIPJANIT NGA TEJKALIMI I TË HYRAVE
VETANAKE PËR VITIN 2014**

Neni 1.

Me këtë Propozim Vendim të bëhet rritja e planifikimit të buxhetit të të hyrave vetanake në shumë prej **136,382.86€**. Kështu që vlera e të hyrave vetanake të arkëtuara nga 1,486,927.00€ rritet në 1,623,309.86€.

Neni 2.

Mjetet nga Neni 1 i këtij Vendimi planifikohen të destinohen si vijon:

Investime Kapitale:

Drejtorati për Shërbime Publike dhe MCE (18163)
Asfaltimi i Rrugës Shqipëria dhe Haradin Bajrami92,601.60€

Mallra dhe shërbime:

Arsim dhe Shkencë- Administrata e Arsimit 90(92015)..... 20,000.00€
Shërbime Publike dhe MCE (18163)..... 17,781.26€
Zyra e Kryetarit 6,000.00€

Totali.....136,382.86€

Të njëjtat mjete në të njëjtat kategori ekonomike barten në vitin 2015.

Neni 3.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 4.

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë të Administrimit të pushtetit lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në faqen elektronike të Komunës.

Neni 5.

Me këtë Vendim të njoftohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Pushteti Lokal, Ministria e Financave, ndërsa një kopje ruhet në materialin e Kuvendit.

Shtesë: Vendimi.

III

Propozimi i Vendimit mbi dhënien e pëlqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitit 2013 dhe 2014 në vitin 2015

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni. i dha fjalën Shkelzen Hajdini, Drejtor i DBF-së i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim i Vendimit,

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Petrit Kelmendi, te të hyrat vetanake që bartën nga vitin 2013 në vitin 2014 dhe të vitit 2014 që bartën në vitin 2015 dashta të pyes Drejtorin pse nuk janë shpenzu në vitin 2013 dhe mos ka pas ndonjë problem që nuk janë realizu e gjithashtu projektet e vitit 2013 që kanë qenë të planifikuara e nuk janë realizu a janë përfshi në vitin 2014.

Agron Hajdini, bartja e të hyrave është obligim ligjor dhe na e përkrahim këtë bartje dhe inkurajojmë drejtoritë respektive që edhe në të ardhmen të punojnë për realizimin e të hyrave.

Florent Hoxha, unë kam potencu edhe në KPF që të gjitha projektet që nuk janë realizu e që barten në vitin 2015 të shkojmë në mënyrë racionale e jo sipas afërsive që janë në mes kompanive apo bizneseve.

Disa projekte si që janë: Kanalizimi në Gadime dhe Krojmir dhe asfaltimi i rrugës në Shalë që kanë qenë të planifikuar për 2014 dhe nuk janë realizu unë nuk po i shoh se janë të planifikuara në vitin 2015 dhe pyes se nga kanë shku mjetet që kanë qenë të planifikuara për këto projekte.

Shkelzen Hajdini, projektet që nuk janë realizu në vitin 2014 na po i qesim mjetet për këto projekt për vitin 2015. Sa i përket kanalizimit në Gadime dhe Krojmir kanë qenë në vitin 2013 dhe nuk kanë qenë shumë mjete por thesari për këto projekte të vitin 2013 i ka hjek mjetet se nuk lejon që dy herë mjetet që nuk janë shpenzu të bartën.

Ali Stublla, tha se 52.000,00€ janë të vitin 2014 e jo të vitit 2013 që tha Drejtori kurse për me u realizu projekti duhet 140.000,00€ dhe Drejtori e din mirë se nuk i ka pas këto mjete për me u realizu projekti dhe kontrata mund të lidhet vetëm kur janë mbi 90% të mjeteve.

Shkelzen Hajdini, na kemi komunikuar për këtë qështje se kemi 54.000,00€ për kryerjen e punëve dhe sipas kontratës me këto mjete është dashtë të kryhet puna 92% meqë operatori nuk e kryer punë këto mjete janë shkuar.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 29 vota për 1 kundër 1 apstenim miratoi këtë:

VENDIM

MBI DHËNJEN E PELQIMIT PËR BARTJEN E TË HYRAVE VETANAKE TË KOMUNËS SË LIPJANIT TË VITIT 2013 DHE 2014 NË VITIN 2015

Neni 1.

Me këtë Vendim barten të hyrat vetanake në shumë prej 863,951.63€ që i përkasin viteve:

-Viti 2014.....821,977.51€
-Viti 2013.....41,974.12€

Neni 2.

Mjetet nga Neni 1 i këtij Vendimi barten:

Tabela 1 Mjetet e mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2014 (21) në Mallra dhe Sherbime prej këtyre

Programeve:

PROGRAMI	Shuma
-Zyra e kryetarit(160)Programi-16003 shuma prej	11,859.82
-Administrata (163)Programi -16303 shuma prej	93,182.18

-Buxhet dhe Financa(175) Programi 17503 shuma prej	7,000.00
-Infrastruktura Publike (180) Programi -18163 shuma prej	65,923.02
-Shëndetsi dhe Mirëqenje Sociale(730)Programi -73200 shuma prej	445.34
-Kulturë, Rini dhe Sport(850) Programi-85003 shuma prej	10,000.00
-Arsim dhe shkence(920) Programi-92250 shuma prej	13,794.77
-Arsim dhe shkence(920) Programi-93060 shuma prej	1,114.00
-Arsim dhe shkence(920) Programi-94261 shuma prej	30,520.66
Totali për Bartje	233,839.79

Tabela1.1 Mjetet e mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2013 (22)në Mallra dhe Shërbime prej këtyre Programeve:

PROGRAMI	Shuma
-Zyra e kryetarit(160)Programi-16003 shuma prej	1,523.02
-Administrata (163)Programi -16303 shuma prej	155.77
-Inspekcioni(166) Programi- 16605 shuma prej	7.52
-Prokurimi (167) Programi -16715 shuma prej	23.05
-Buxhet dhe Financa(175) Programi 17503 shuma prej	2,196.36
-Infrastruktura Publike (180) Programi -18163 shuma prej	640.36
-Zjarrfikset (180) Programi- 18215	53.70
-Shëndetsi dhe Mirëqenje Sociale(730)Programi -73200 shuma prej	24.55
-Qendra për Punë Sociale(755) Programi-75511 shuma prej	8.10
-Arsim dhe shkence(920) Programi-92250 shuma prej	241.75
-Arsim dhe shkence(920) Programi-93060 shuma prej	5,493.37
-Arsim dhe shkence(920) Programi-94261 shuma prej	774.84
Totali për Bartje	11,142.39

Mjetet nga tabela 1(të hyrat e vitit 2014) dhe 1.1 (të hyrat e vitit 2013) barten në tabelen 1.2. Mallra dhe Shërbime:

Tabela nr.1.2.

PROGRAMI	Shuma
-Zyra e kryetarit(160)Programi-16003 shuma prej	13,382.84
-Administrata (163)Programi -16303 shuma prej	93,337.95
-Buxhet dhe Financa(175) Programi 17503 shuma prej	9,288.73
-Infrastruktura Publike (180) Programi -18163 shuma prej	66,563.38
-Shëndetsi dhe Mirëqenje Sociale(730)Programi -73200 shuma prej	469.89
-Kulturë, Rini dhe Sport(850) Programi-85003 shuma prej	10,000.00
-Arsim dhe shkence(920) Programi-92250 shuma prej	14,036.52
-Arsim dhe shkence(920) Programi-93060 shuma prej	6,607.37
-Arsim dhe shkence(920) Programi-94261 shuma prej	31,295.50
Totali për Bartje	244,982.18

Tabela 2. Mjetet e mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2014 (21) në Komunalitë prej këtyre Programeve:

PROGRAMI	Shuma
-Zyra e kryetarit(160)Programi-16003 shuma prej	3,100.00
-Shëndetsi dhe Mirëqenje Sociale(730)Programi -73200 shuma prej	4,232.75
Totali për Bartje	7,332.75

Tabela2.1. Mjetet e mbetura nga të hyrat vetanake te vitit 2013 (22)në Komunalitë prej këtyre Programeve:

PROGRAMI	Shuma
-Administrata (163)Programi -16303 shuma prej	16,900.00

-Infrastruktura Publike (180) Programi -18163 shuma prej	4,811.03
-Kulturë, Rini dhe Sport(850) Programi-85003 shuma prej	1.20
Totali për Bartje	21,712.23

Mjetet nga tabela 2 dhe 2.1 barten në tabelen 2.2. në Komunal

Tabela nr. 2.2

PROGRAMI	Shuma
-Zyra e kryetarit(160)Programi-16003 shuma prej	3,100.00
-Administrata (163)Programi -16303 shuma prej	16,900.00
-Infrastruktura Publike (180) Programi -18163 shuma prej	4,812.23
-Shëndetsi dhe Mirëqenje Sociale(730)Programi -73200 shuma prej	4,232.75
Totali për Bartje	29,044.98

Tabela 3. Mjetet e mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2014 (21) në Subvencione dhe Transfere prej këtyre Programeve:

PROGRAMI	Shuma
-Zyra e kryetarit(160)Programi-16003 shuma prej	36,530.00
-Zyra e Lokale e Komuniteteve(195) Programi-19515 shuma prej	500.00
-Bujqësia (470) Programi -47003 shuma prej	1,701.00
-Administrata e Shendetesise (730)Programi 73012	300.00
-Kulturë, Rini dhe Sport(850) Programi-85003 shuma prej	8,300.00
Totali për Bartje	47,331.00

Tabela 3.1. Mjetet e mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2013 (22) në Subvencione dhe Transfere prej këtyre Programeve:

PROGRAMI	Shuma
-Zyra e kryetarit(160)Programi-16003 shuma prej	705.00
-Bujqësia (470) Programi -47003 shuma prej	3,614.52
-Administrata e Shendetesise (730)Programi 73012	0.50
-Kulturë, Rini dhe Sport(850) Programi-85003 shuma prej	80.00
Totali për Bartje	4,400.02

Mjetet nga tabela 3 dhe 3.1 barten në tabelen 3.2. në Subvencione dhe Transfere prej këtyre Programeve:

Tabela 3.2

PROGRAMI	Shuma
-Zyra e kryetarit(160)Programi-16003 shuma prej	37,235.00
-Zyra e Lokale e Komuniteteve(195) Programi-19515 shuma prej	500.00
-Bujqësia (470) Programi -47003 shuma prej	5,315.52
-Administrata e Shendetesise (730)Programi 73012	300.50
-Kulturë, Rini dhe Sport(850) Programi-85003 shuma prej	8,380.00
Totali për Bartje	51,731.02

Tabela.4. Mjetet e mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2014 (21) në Paga dhe Meditje prej këtyre Programeve:

PROGRAMI	Shuma
-Arsim dhe shkence(920) Programi-93060 shuma prej	30,000.00
Totali për Bartje	30,000.00

Tabela.4.1 Mjetet e mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2013 (22) në Paga dhe Meditje prej këtyre Programeve:

PROGRAMI	Shuma
-Arsim dhe shkence(920) Programi-93060 shuma prej	116.52
Totali për Bartje	116.52

Mjetet nga tabela 4 dhe 4.1 barten ne tabelen 4.2. në Subvencione dhe Transfere prej këtyre Programeve:

Tabela 4.2

PROGRAMI	Shuma
-Arsim dhe shkence(920) Programi-93060 shuma prej	30,116.52
Totali për Bartje	30,116.52

Tabela 5. Mjetet e Mbetura nga të hyrat vetanake(21) në Investime Kapitale prej këtyre Programeve:

PROGRAMI	Shuma
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),„Asfaltimi i rrugës Shqipëria-Hajredin Bajrami”	54,639.91
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),„Asfaltimi i rrugëve brenda qytetit të Lipjanit”	16,239.66
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),„Rregullimi i trotuareve në qytetin e Lipjanit”	64,881.09
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),„Bashkëfinancim me donatore”	114,440.81
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),„Rregullimi i hapsirës së kontinierëve në qytet”	7,257.96
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),„Rregullimi i urave neqytetin e Lipjanit”	11,705.21
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),„Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve”	17,275.98
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),„Ndërtimi i rrjetit të ujësjes në 20 fshatra	200,000.00
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),„Rehabilitimi i kanal në Kraishtë, Ribar i M.Ribar i V. Torinë,Dobrajë M,Llugë-Faza e I	9,500.00
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),„ Rregullimi i kanalizimit fekal në fsh.Llugë”	1,542.45
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),„ Rregullimi i kanalizimit fekal në fsh.Kojksë”	5,990.90
Totali për Bartje	503,473.97

Tabela 5.1. Mjetet e Mbetura nga të hyrat vetanake(22) në Investime Kapitale prej këtyre Programeve:

PROGRAMI	Shuma
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),„Ndërtimi i trotuarëve fsh.Gadime e Eperme dhe Ultë”	0.61
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),„Bashkëfinancim me donatore”	4,602.35
Totali për Bartje	4,602.96

Mjetet nga tabela 5 dhe 5.1. barten në tabelen 5.2 barten në këto projekte:

Tabela 5.2

PROGRAMI	Shuma
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),„Asfaltimi i rrugës Shqipëria-Hajredin Bajrami”	274,342.37
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),„Asfaltimi i rrugëve brenda qytetit të Lipjanit”	65,647.75
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),„Rregullimi i trotuareve në qytetin e Lipjanit”	36,937.39
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),„Bashkëfinancim me donatore”kodi i projektit (89240)	50,000.00
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),„Rregullimi i hapsirës së kontinierëve në qytet”	4,476.70
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),„Rehabilitimi i kanal në Kraishtë, Ribar i M.Ribar i V. Torinë,Dobrajë M,Llugë-Faza e I	9,019.97
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),„ Rregullimi i kanalizimit fekal në fsh.Llugë”	1,542.45
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),„ Rregullimi i kanalizimit fekal në fsh.Kojksë”	5,990.90
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),„ Rehabilitimi i kanalizimit Bujari”	41,852.08
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),„Asfaltimi i rruges ne fsh.Torinë”	9,644.36
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),„Ndertimi i Qendres rinore ne Magurë”	4,020.00
-Infrastruktura Publike-Programi(18163),„Bashkëfinancim me donatore” kod i projektit (87212)	4,602.96
Totali për Bartje	508,076.93

Neni 3.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Neni 4.

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë të Administrimit të pushtetit lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në faqen elektronike të Komunës.

Neni 5.

Me këtë Vendim të njoftohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Pushteti Lokal, ndërsa një kopje ruhet në materialin e Kuvendit.

Shtesë: Vendimi.

IV

Shqyrtimi i propozim Vendimit për plotësimin e Vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të palujtëshme të Komunës 15Nr.464-40375/2014

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni i dha fjalën Ilir Tasholli Drejtor i DPU-së i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit.

Pastaj Kryesuesja Vlora Limani-Hajnuni hapi shqyrtimin?

Petrit Kelmendi, është mirë që Vendimet para se të vijnë për shqyrtim në Kuvend të korigjohen nga zyra ligjore në mënyrë që mos të kthehen nga Ministria për ndryshime apo plotësime të tyre.

Pastaj tha se kemi dy zona industriale ku kemi dhënë toka në shfrytëzim dhe është mirë që të përgaditet një informatë apo raport se sa janë realizu kopntratat për pronat që janë dhënë.

Labinot Shahini, na e kemi aprovu këtë Vendim më parë por vetëm duhet të plotësohet për kohëzgjatëjes e dhënies në shfrytëzim dhe na si grup parlamentar i LDK-së e përkrahim këtë Vendim.

Xhevat Olluri, na të gjithë e kemi bërë këtë lëshim kur e kemi aprovu Vendimin dhe nuk kemi çka e zgjasim se për qdo dhënie në shfrytëzim të pronës duhet të parashihet edhe kohëzgjatja e që kjo i ka mungu Vendimit, andaj na e përkrahim.

Blerim Gashi, na kemi dhënë toka në shfrytëzim në zona industriale dhe nuk e dijmë se si janë realizu ato kontrata, andaj propozoj që të rishikohen ato kontrata në mënyrë që të dijmë se si janë realizu.

Florent Hoxha, kur është aprovu ky Vendim ne si grup parlamentar i PDK-së kemi qenë kundër këtij Vendimi dhe kemi kërku që ky Vendim duhet të bazohet në Planin Zhvillimor Urban dhe meqë ky Vendim nuk është harmonizu me këtë plan dhe se sipas këtij plani kjo pjesë është e destinume për nxjerrje të lignitit dhe për këtë arsye ne si grup i PDK-së jemi kundër këtij Vendimi.

Ilir Tasholli, edhe ne jemi që të rishqyrtohen kontratat e dhënies së pronave në shfrytëzim dhe sot kemi një Vendim i cili është aprovu më heret vetëm duhet një plotësim i afatit për dhënien në shfrytëzim dhe qëllimi i këtij Vendi është zhvillimi ekonomik i Komunës.

Meqë diskutime tjera nuk parti Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 20 vota për 9 kundër 1 apstenim miratoi këtë:

VENDIM

PËR PLOTËSIMIN E VENDIMIT PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS 15NR.464-40375/2014

1.Me këtë Vendim, plotësohet pika 2 e Vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr.464-40375 dt..29.09.2014, dhe përkufizohet si në vijim:

“Sipas pikës 1 të këtij Vendimi pronat e paluajtshme ipen në shfrytëzim në afat prej 99 vitesh nëpërmjet konkursit publik të përcaktuar sipas Rregullores QRK nr. 23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës”.

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronave të komunës është ndërtimi i ndonjë fabrike prodhuese-përpunuese, tregtare apo të ngjajshme, sipas standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore.

2. Ndërsa pikët e tjera të Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës, mbasin të pandryshuara.

3. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqen e Komunës.

4. Me këtë Vendim të njoftohet Zyra e Kryetarit-Sektori Pronësoresh Juridik, Ministria e Pushtetit Lokal, ndërsa një kopje ruhet në materialin e Kuvendit.

Shtesë: Vendimi.

V

Shqyrtimi i propozim Vendimit për plotësimin e Vendimit për dhënien në shfrytëzim të tokës pasuri shoqërore e KK Lipjan ,KBI (Këshillit të Bashkësisë Islame) për Xhaminë e Fshatit Gadime e Epërme 15Nr.464-40387/2014

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni i dha fjalën Basri Hashani Drejtor i DKRS i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit.

Pastaj Kryesuesja Vlora Limani-Hajnuni hapi shqyrtimin?

Nehat Tërpeza, edhe ky propozim Vendim është shqyrtu në grupin parlamentar të LDK-së dhe është vetëm plotësim dhe na e përkrahim.

Florent Hoxha, na e kemi përkrah këtë Vendim edhe më herët por në vendim duhet të përfshihet edhe nenin 12 i Rregullores nr. 23/2013 meqë neni 11 i përfshirë në Vendim nuk e parasheh afatin e dhënies në shfrytëzim dhe ne si grup i PDK-së e përkrahim këtë Vendim.

Ramiz Qeriqi, flitet për dhënien e tokës në shfrytëzim për 99 vjet dhe unë pyes se qka pas 99 vjete.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 30 vota për asnjë kundër asnjë apstenim miratoi këtë:

VENDIM

PËR PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË TOKËS-PASURI SHOQËRORE E KK LIPJAN, KBI-së (Këshilli i Bashkësisë Islame) PËR XHAMINË E FSHATIT GADIME E EPËRME 15NR.464-40387/2014

1. Me këtë Vendim, plotësohet pika 3 e Vendimit për dhënien në shfrytëzim toka-pasuri shoqërore e KK Lipjan, KBI-së (Këshilli i Bashkësisë Islame) në Lipjan 15NR.464-40387 dt.29.09.2014, dhe përkufizohet si në vijim:

“Kjo sipërfaqe e tokës si në nenin 1 të këtij Vendimi ipet në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh Xhamisë në fshatin Gadime e Epërme, për ushtrimin e rregullt të aktiviteteve fetare”.

2. Ndërsa nenet e tjera të Vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, mbasin të pandryshuara.

3. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqen e Komunës.

4.Me këtë Vendim të njoftohet Zyra e Kryetarit-Sektori Pronësoreshë Juridik, Ministria e Pushtetit Lokal, ndërsa një kopje ruhet në materialin e Kuvendit.

Shtesë: Vendimi.

VI

Shqyrtimi i propozimit të Vendimit për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare BI në Lipjan

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni i dha fjalën Basri Hashani Drejtor i DKRS i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit.

Pastaj Kryesuesja Vlora Limani-Hajnuni hapi shqyrtimin?

Merita Zeqiri-Hajrizi, kjo është bërë rutinë dhe sipas këtij Vendimi flitet për 63 raste dhe unë e di një rast në dhjetor një familje ka pasur rast vdekje dhe shpenzimet i ka hjek vetë familja.

Nehat Tërpeza, këtë Vendim e kemi shqyrtu në grupin parlamentar të LDK-së dhe e përkrahim, mirëpo kemi një kërkesë që BI të paraqet një raport për shpenzimet e varrimit meqë unë kam pasur rast vdekje ku më ka vdek babai dhe për pastrim të kufomës kam paguar 60 euro kurse pas rastit tim për pastrim të kufomës kanë paguar nga 30 euro, e gjithashtu kemi raste ku familjarët varrin e kanë hapur vetë dhe për këto arsye po kërkojmë që të paraqitet raport nga BI.

Enver Kozhani, na si grup parlamentar i PDK-së e mbështesim këtë Vendim për shpenzimet e varrimit dhe mendoj se me këtë bëhet një lehtësim për familjarët. Në vazhdim tha se kemi një shqetësim i cili në bazë të të dhënave nga terreni, BI me këto mjete në shumë prej 110 euro për një varrim mbulon vetëm pjesën e varrimit (dërrasat, qefinin, hapjen e varrit dhe transportin e kufomës), por jo edhe ceremonitë fetare të cilat prap i mbetet barrë familjarëve në vlerë prej 70 euro. Nga kjo del se Komuna po i mbulon shpenzimet e varrimit pjesërisht, andaj është mirë që Komuna t'i mbulon shpenzimet e varrimit komplet meqë në opinion po thuhet se Komuna po i hjek shpenzimet e varrimit. Na si grup parlamentar i PDK-së kërkojmë hartimin e një Rregullore për shpenzimet e varrimit në të cilën Rregullore do të specifikohen detalisht këto shpenzime.

Fitim Selimi, na kemi pas debat për këtë dhe e kemi specifikuar që për një varrim shpenzimet të caktohen 110 euro dhe këto shpenzime duhet të paraqiten me faktura se na nuk jemi shoqatë humanitare por jemi institucion dhe qdo shpenzim duhet të arsyetohet.

Blerim Gashi, na duhet ta marrim këtë Vendim meqë BI është borxh por për të ardhmen kjo qështje duhet të rregullohet me Rregullore. Gjithashtu konsideroj se të gjithë qytetarët nuk janë të informuar se Komuna i hjek shpenzimet e varrimit.

Ramiz Qeriqi, unë propozoj që kësaj here ta aprovojmë këtë Vendim kurse për mbledhjen e ardhshme e kemi një pikë të veçantë për këtë qështje dhe të vendosim një mënyrë të pagesës dhe mos të merremi çdo mbledhje me këtë qështje.

Arben Bahtiri, unë e kisha një dilemë pse nuk ka prit BI të përmbillet viti se ata kanë planifikuar 63 raste dhe po bie se sikurse me ditë se sa raste kanë me ndodh.

Labinot Shahini, në vitin e kaluar në janar e kemi shqyrtuar këtë qështje dhe kam kërkuar që të nxirret një Rregullore. Unë e kam diskutu me Kryetarin që këto mjete t'i marrin drejtpërdrejt familjarët por nuk ka mundësi ligjore.

Florent Hoxha, na edhe më herët kemi kërku që të nxirret një Rregullore dhe Drejtori i Shërbimeve Publike ka thënë se ka përgatit një draft Rregullore dhe kërkoj që kjo Rregullore në mbledhje të ardhshme të silltet në Kuvend.

Vlora Limani – Hajnuni, mendoj se duhet të përkrahet ky propozim Vendim pavarësisht debatit i cili u debatu këtu dhe është një mësim për BI në mënyrë që nga ky debat BI të korigjoj

lëshimet që ka pas. Unë pajtohem me Blerimin se qytetarët nuk e dinë se cilat shpenzime i heq Komuna por na të gjithë jemi nga Lipjani dhe mund t'i informojmë qytetarët.

Pasi diskutime tjera nuk pati Kryesuesja vuri në votim propozim Vendimin dhe pas votit konstatoi se Kuvendi me 29 vota për 1 kundër miratoi këtë:

VENDIM
PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË
ISLAME NË LIPJAN

Neni 1

I ipet pëlqimi, Kryetarit të Komunës për marjen e Vendimit për ndarjen mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan në shumë prej 6930 €, (gjashtë mijë e nëntëqind e tridhjetë euro) euro për subvencionim të shpenzimeve të varrimeve, për 63 raste të vdekjes të cilat kanë ndodhur prej datës 01.10.2014 deri më 23.12.2014 nga 110 euro për secilin rast $110 \times 63 = 6930$.

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të subvencionohet nga kategoria ekonomike - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës për vitin 2015.

Neni 3

Per zbatimin e këtij vendimi do kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqen e Komunës.

Neni 5

Me këtë Vendim të njoftohet Zyra e Kryetarit-Sektori Pronoro Juridik, Ministria e Pushteti Lokal, ndërsa një kopje ruhet në materialin e Kuvendit.

Pasi çështje të tjera nuk pati mblledhja përfundoi në ora 14,²⁰

Ekstraktin e hartoi
Sami Murati

Kryesuesja e Kuvendit
Vlora Limani-Hajnuni